



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo za Obrazovanje Nauku, Tehnologiju i Inovacije
Ministry of Education Science, Technology and Innovation

UDHËZIME PËR DREJTORITË KOMUNALE TË
ARSIMIT PËR REALIZIMIN E MËSIMIT ONLINE
PËR SHKOLLAT E MESME TË LARTA
PROFESIONALE (SHML) DHE QENDRAT E
KOMPETENCËS

Prishtinë, Mars, 2020

HYRJE

Në bazë të nenit 5, pika 1.3 dhe 1.4 të Ligjit (04/L-032) për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në zbatim të vendimit 01/07 të datës 11.03. 2020, MASHTI ka vendosur të fillojë zbatimin e mësimin online në të gjitha institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Në përputhje me këtë vendim, MASHTI ka vendosur përfshirjen edhe të shkollave të arsimit të mesëm të lartë profesional dhe Qendrave të Kompetencës. Zbatimi i mësimin online ka për qëllim sigurimin e shërbimeve arsimore dhe realizimin e kurrikulës shtetërore të Kosovës në përputhje me kushtet e krijuara në rrethana të pandemisë COVID – 19.

VENDIMI I MASHTI PËR SHKOLLAT E MESME TË LARTA PROFESIONALE DHE QENDRAT E KOMPETENCËS:

Pas shqyrtimit të mundësive të ndryshme përkitazi me mësimin në distancë për arsimin e mesëm të lartë, MASHTI kërkon nga DKA-të të fillojnë përgatitjet për zhvillimin e mësimin në distancë me nxënësit e shkollave profesionale në mënyrë të decentralizuar në nivel shkolle. Kërkohet nga Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe shkollat përkatëse që të fillojnë përgatitjet për zbatimin e mësimin online prej datës 30 mars 2020 me mundësi që tri ditët e para të shërbejnë për përshtatje të mësimdhënësve dhe strukturave për formën e re të punës.

MËNYRA E ZBATIMIT

MASHTI ka shqyrtuar modalitetet e ndryshme të realizimit të mësimin për shkollat e mesme të larta profesionale. Duke e pasur parasysh natyrën e mësimin në arsimin profesional (puna praktike, profilet e shumta, mungesën e teksteve shkollore për shumicën e lëndëve profesionale, puna laboratorike e të tjera) MASHTI është përcaktuar për MODALITETIN E KUFIZUAR.

Kjo nënkupton se shkollat profesionale gjatë periudhës së ndërprerjes së mësimin, realizojnë mësimin online në lëndët e përgjithshme (gjuhë amtare, matematikë, gjuhë e huaj e të tjera), dhe në ndonjë lëndë teorike të fushës / profilit. Ndërsa, pas rifillimit të mësimin, ato do të organizojnë mësimin në bllok vetëm për lëndët specifike profesionale, praktikën profesionale dhe segmentet e lëndëve që kërkojnë punë laboratorike.

Në të dyja rastet e mësipërme nxënësve u njihet mësimi i vijuar online për lëndët e përgjithshme dhe vazhdojnë në bllok mësimin në lëndët praktike, në lëndët me përmbajtje më specifike profesionale dhe në ato me përmbajtje laboratorike pas rifillimit të mësimin në objekte. Njohja e mësimin nuk do të bëhet në mënyrë automatike, pasi që kërkohet

plotësimi i kërkesave të punës edhe në kushte të mësimit online (për këtë MASHTI do të dërgojë udhëzues të veçantë).

Pas rifillimit të mësimit, mësime të lëndëve të përgjithshme që kanë realizuar mësimin online, angazhohen në përkrahjen e nxënësve për testimet e duhura (përsëritje, vlerësim, kontrollim i portfoliove etj), dhe në përkrahjen e realizimit të mësimit bllok sipas vlerësimit të menaxhmentit të shkollës.

Në rast të vazhdimit të gjendjes së emergjencës përtej periudhës njëmuajore, MASHT do të rishikojë këtë modalitet të mësimit online për shkollat e mesme të larta profesionale dhe do t'u dërgojë shkollave vendimet dhe instruksionet përkatëse. Qendrat e Kompetencës do të kontaktohen për të parë nëse mund të ofrojnë më shumë përkrahje për shkollat profesionale të profileve përkatëse.

Format e tjera të përkrahjes janë në përputhje me udhëzimin e përgjithshëm për SHML të dërguar nga MASHTI më 26 mars 2020.